



Planimar / Dateduar Primitje / Predato Received / Delivered	19.09.2022	2	viti god year
Organ / Bëvesia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Rr / Prot Rr / Prot Prof No	Shtjorja Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHKK	5492/2022		119

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.662/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj - anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.662/2021 të datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 19.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.662/2022 e datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesi**

**II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.849 i datës 25.07.2022, i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi ka qenë i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas Akt emërimit të datës 21.09.2012, në pozitën "Udhëheqës i Divizionit Ligjor", në Drejtorinë Qendrore. Me datën 25.07.2022, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.849, sipas të cilit ankuesin e ka caktuar nga pozita Udhëheqës i divizionit ligjor "në Drejtorinë Qendrore të SHKK-së në pozitën "Udhëheqës i sektorit për punë juridike dhe të përgjithshme "në Qendrën e parburgimit në Mitrovicë, me arsyetimin se pozita e "Udhëheqësit të divizionit ligjor" nuk parashihet në Rregulloren QRK.Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr.849/2022 të datës 25.07.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 26.07.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4311/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 01.08.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me datën 05.08.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 07.09.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.91/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4311/2022 të datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër A.nr.474/2022 të datës 07.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me nr.848 të datës 25.07.2022 për zbatimin e vendimit të Këshillit; Vendimin me nr.849 të datës 25.07.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Akt emërimit të ankuesit të datës 21.09.2012; plotësim ankesën e datës 09/08/2022 për KPMSHCK; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës të datës 05.08.2022 me numër protokollit 4550/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës-11 faqe; shkresa 05/08/2022-shkresat e lëndës për përgjigje në ankesë; ;Vendimin me numër VK.nr.91/2022 të datës 07.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me shtyrjen e afatit të ankesës së ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat dhe provat e lëndës meqenëse nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, konkretisht sipas Vendimit Nr.849 të datës 25.07.2022, të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, është konstatuar fakti që pozita "Udhëheqës i "Divizionit Ligjor" nuk është e paraparë si pozitë në Rregulloren QRK-Nr.31/2013 për Organizmin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, atëherë me doemos ka qenë e nevojshme që të bëhet sistemimi i ankuesit në një pozitë që është e lirë dhe që është përfshirë në organogramin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, kështu që me datën 25.07.2022 është nxjerrë Vendimi me Nr.849 me të cilin ankuesi është caktuar në pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Punë Juridike dhe të Përgjithshme "në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë. Bazuar në Rregulloren QRK-



Nr.31/2013 për Organizmin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, pozita "Udhëheqës i Sektorit për Punë Juridike dhe të Përgjithshme është paraparë me nenin 102 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, andaj mbi bazën e kësaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se meqë pozita "Udhëheqës i Sektorit për Punë Juridike dhe të Përgjithshme ka qenë pozitë e lirë dhe nuk ka asnjë dëshmi që brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës është bërë shuarja apo ristrukturim i institucionit, respektivisht është bërë ristrukturimi apo shuarja e pozitave, atëherë në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk ka qenë e nevojshme të bëhet komision ristrukturimi, sepse komisioni i ristrukturimit bëhet vetëm në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit, siç parashihet me nenin 54 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "*Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta...*".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Vendimi Nr.849 i datës 25.07.2022 i Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se çështja e caktimit të ankuesit nuk ndërlihet me çështjen e transferimit të përhershëm, ngase ankuesi nuk është transferuar me vendimin e lart cekur, mirëpo është caktuar në një pozitë tjetër meqë pozita të cilën e ka mbajtur nuk ka qenë fare e paraparë si pozitë në Rregulloren QRK-Nr.31/2013 për Organizmin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, në këtë kuptim edhe pretendimi i tij është i pa bazuar dhe jo i drejtë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se në bazë të Vendimit me Nr.849 të datës 25.07.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me të cilin ankuesi është caktuar në pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Punë Juridike dhe të Përgjithshme" në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, i njëjti në bazë të këtij vendimi nuk është dëmtuar në pagë, ngase koeficientin e realizon sipas pozitës të cilën e ka mbajtur, andaj bazuar në konstatimet e mësipërme pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.662/2021, datë 19/09/2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

